



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____

Datë _____ / _____ / 2022

Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-Ndhmën Ekonomike

dhe Ndhmën Ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, për periudhën 1-31 /08/2022 .

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6. Ligjit nr.147 datë 22.12.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”.

Ligji nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, të V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të neneve 12, pikat 1,4,5,16, pika 2 dhe 21 të ligjit nr 57/2019 “Për asistencen Sociale në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5, pika 2, datë 17.02.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Vendimit nr. 4 dhe nr. 5, datë 27.01.2022 të Këshillit Bashkiak Korçë , **“Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike” dhe nga fondi i buxhetit vendor të Bashkisë si dhe duke u mbështetur në Ligjin Nr. 57/2019“ Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”**

Këshilli i Bashkisë në lidhje me pagesat e Ndhmës Ekonomike për muajin **Gusht 2022**, sipas propozimit të Administratorëve shoqërorë :

VENDOSI

FONDI NË Lekë

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga verifikimet e kryera konkludojmë dhe propozojmë:

1- Të përfitojnë 50 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën **127.776 lekë.**

2- Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 24 familje, në shumën **30.264 lekë.**

3- Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 158.040 lekë.

4- Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor ,sipas kriterëve specifike të miratuara 13 familje, me fond prej **32.054 lekë .**

Ky fond është parashikuar si 6 % nga fondi i kushtëzuar, për bllok ndihmën ekonomike dhe nga fondi i buxhetit vendor, i miratuar me VKB nr.4 dhe nr.5 datë 27.01.2022.

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Eva NAÇI

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Erjon NEXHIPI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____ datë ____/____/2022

**PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT KËSHILLIMOR
PËR DHËNIEN E TITULLIT QYTETAR NDERI
AT GARY WALSH**

Bazuar në Ligjin Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në Ligjin Nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë” dhe V.K.B nr. 80 datë 30 .07.2020 “për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak Korçë”, neni 51 “Komiteti Këshillimor për Dhënien e Medaljeve dhe Titujve Vendorë të Nderit , dhe V.K.B-në nr.108 datë 30.09.2021 "Për Fillimin e Proceduarve Për Ngritjen, Përbërjen dhe Funksionimin e Komitetit Këshillimor për Dhënien e Medaljeve dhe Titujve Vendorë të Nderit" Këshilli Bashkiak;

VENDOSI:

1. Të miratojë ngritjen dhe përbërjen e Komitetit Këshillimor për Dhënien e Medaljeve dhe Titujve Vendorë të Nderit, ku tre (3) -anëtarë janë të Këshillit Bashkiak, si më poshtë:
-Ana Verushi
-Irena Nikaj
-Pandë Bello

2. Dy (2) anëtarët e tjerë duhet të jenë personalitete të jashtme që kanë dhënë kontribut në fushën përkatëse, do të përzgjidhen rast pas rasti në varësi të propozimeve dhe kërkesave të administruara, dhe sipas kriterëve specifike të përcaktuara.
3. Për propozimin që i është drejtuar këshillit për At Gary Walsh si misionar në ndihmë të varfërve dhe shtresave në nevojë si dhe kontribues në ngritjen dhe hapjen e shkollës kolegji "Preka" si dhe klinikës për kujdesin paliativ Mary Potër etj. , në këtë rast personalitetet duhet të jenë të fushës së përkatëse , si më poshtë;
-.
-.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komiteti Këshillimor për Dhënien e Medaljeve dhe Titujve Vendorë të Nderit dhe Komisioni Për Përcaktimin e Kriterëve Specifike.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

Kryetari

Erjon Nexhipi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr._____ Datë_____

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PËRDORIMIT TË FONDIT TË TRASHËGUAR
NGA TRANSFERTA SPECIFIKE E VITIT 2021 NË BUXHETIN E VITIT 2022**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit plotësues nr. 1 datë 10.1.2022 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, VKB nr. 6 datë 27.1.2022 “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, VKB nr. 21 datë 10.2.2022 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2021 të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2022” si dhe VKM nr. 414, datë 8.7.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e përdorimit të fondit të trashëguar nga transfertat specifike e vitit 2021 në buxhetin e vitit 2022, në vlerën 3,305,300 lekë, nga zëri shpenzime për investime (blerje automjeti zjarrfikese per MNZSH), në zërin transfertat tek individët, (shpenzime për përballimin e dëmeve nga zjarri dhe fatkeqesi natyrore), me këtë strukturë buxhetore:

PAKESOHET 00 03280 01 Art. 2310000 -3,305,300 lekë (Prog. Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile, Bashkia)

SHTOHET 00 03280 01 Art. 6060000 + 3,305,300 lekë ""

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK, Drejtoria e Përgjithsme Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Prokurimeve dhe Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Erjon Nexhipi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____ Datë _____

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR 79 DATË 23.5.2022 “PËR DETAJIMIN
DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR MBROJTJEN
CIVILE”**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit plotësues nr. 1 datë 10.1.2022 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, VKB nr. 6 datë 27.1.2022 “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, VKM nr. 414, datë 8.7.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, si dhe VKB nr. 79 datë 23.5.2022 “Për detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e përdorimit dhe detajimin e fondit të kushtëzuar për Mbrojtjen Civile sipas tabelës së mëposhtme:

/lekë

Nr.	Zërat e shpenzimeve të buxhetit për Fondin e Kushtëzuar të Mbrojtjes	Ishte	Pakësohet	Shtohet	Bëhet
-----	--	-------	-----------	---------	-------

	Civile				
1	Shpenzime për përballimin e dëmeve nga zjarri dhe fatkeqësi natyrore	4,621,278.00	4,621,278.00		0.00
2	Shpenzime për blerje paisje profesionale	8,540,000.00	1,115,480.00		7,424,520.00
3	Rehabilitim në objekte infrastrukture	4,000,000.00			4,000,000.00
4	Shpenzime për blerje karburanti (e prokuruar)	5,000,000.00			5,000,000.00
5	Shpenzime për blerje karburanti			2,861,758.00	2,861,758.00
6	Shpenzime për prishjen e objekteve infrastrukture që përbëjnë rrezik për jetën e njerëzve	1,500,000.00	1,500,000.00		0.00
7	Shpenzime për blerje kripe	3,000,000.00		1,375,000.00	4,375,000.00
8	Ndërtim I pritave malore në fshatin Neviçisht			3,000,000.00	3,000,000.00
	Shpenzime total	26,661,278.00	7,236,758.00	7,236,758.00	26,661,278.00

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK, Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Prokurimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Erjon Nexhipi



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/Vendim

Nr. Datë

**PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 146 DATË 22.12.2021 “PËR MIRATIMIN
E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË
ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2022”**

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në VKM nr. 234 datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” dhe në VKM nr. 604 datë 14.09.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”

VENDOSI:

1. Në VKB nr. 146 datë 22.12.2021 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar në institucionin e Bashkisë dhe institucioneve të varësisë për vitin 2022”, të ndryshohen kategoritë fikse për klasat I, II, III si më poshtë:

Kategoria fikse	Pagat sipas kategorive
Pika 19 klasa I	34 000
Pika 19 klasa II	34 000
Pika 19 klasa III	34 000

2. Efektet financiare të rritjes së pagës minimale do të përballohen nga buxheti i vitit 2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Ndërmarrjet e varësisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT

Erjon NEXHIPI



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____ Datë _____

**PËR MIRATIMIN E RITJES SË PLANIT TË BUXHETIT DHE
PËRDORIMIN E FONDIT PËR RITJEN E PAGAVE PËR FUNKSIONIN
E ARSIMIT PARASHKOLLOR NË NDËRMARRJEN E SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE TË ARSIMIT DHE ÇERDHES**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK si dhe nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, udhëzimin nr. 9 datë 20.07.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimit plotësues nr. 1 datë 10.1.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, VKM nr. 465 datë 6.7.2022 “Për disa ndryshime në VKM nr. 175 datë 8.3.2017 “Për trajtimin me page dhe shtesa mbi page të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve jo mësimorë në arsimin parauniversitar, të ndryshuar, VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë, VKB nr. 6 datë 27.1.2022 “Për rishqyrtimin e VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, I ndryshuar, të shkresës me nr. 16040 datë 29.8.2022 nga MFE, si dhe mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë rritjen e planit të buxhetit në vlerën 3,320,272 lekë, për programin Arsimi bazë, parashkollor, në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes.
2. Të miratojë përdorimin e fondit për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore në programin arsimi bazë dhe parashkollor në NSHMAC, si më poshtë dhe me këtë strukturë buxhetore :

SHTOHET 00 09120 01 Art. 6000000 +2,840,000 lekë (Prog ars. Bazë parashk, NSHMAC)

SHTOHET 00 09120 01 Art. 6010000 + 480,272 “”

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK si dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Erjon Nexhipi



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____ Datë _____

Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, faza e dytë.

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK, duke u bazuar në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, Udhëzimin nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 23 datë 8.7.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

- 1 Të miratojë programin buxhetor afatmesëm 2023-2025, faza e dytë, të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
- 2 Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Korçë.
- 3 Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Erjon Nexhipi



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. ____ datë ____/____/2022

**“Për disa ndryshime të Vendimit Nr. 25, dt. 27/02/2020 të Këshillit të Bashkisë
Korçë për themelimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike, bazuar në nenin 29 të ligjit 139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, bazuar në ligjin 108/2014 për Policinë e Shtetit, Neni 11 pika 3, Neni 78 dhe Neni 79, si dhe pas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të ndryshojë përbërjen e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) (Pika 1 e vendimit Nr. 25, dt. 27/02/2020). Përbërja e KVSP do të jetë si më poshtë vijon:
 1. Kryetari i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike Korçë është Kryetari i Bashkisë
 2. Kryetari i Këshillit Bashkiak
 3. Shefi i Komisarariatit të Policisë, Korçë (njëherazi edhe Zv. Kryetar i KVSP-së) dhe Shefi i Seksionit të Policimit në Komunitet pranë Komisarariatit të Policisë Korçë
 4. Prefekti i Qarkut të Korçës
 5. Drejtuesi i policisë bashkiake
 6. Drejtori i administratës së shërbimeve sociale pranë Bashkisë Korçë
 7. Drejtori i Emergjencave Civile për Qarkun Korçë
 8. Përfaqësues nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë
 9. Përfaqësues nga Prokuroria e Korçës
 10. Drejtori i Drejtorisë Arsimore Rajonale, Korçë
 11. Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, Korçë
 12. Drejtori i Drejtorisë Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Korçë
 13. Drejtuesi i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Myftinia Korçë
 14. Drejtuesi i Komunitetit Katolik Shqiptar, Korçë

15. Drejtuesi i Komunitetit Ortodoks Shqiptar, Korçë
16. Përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile në Korçë (3 përfaqësues)
17. Përfaqësues nga mediat lokale, Korçë
18. Përfaqësues nga shoqatat vendore të biznesit, Korçë
19. Përfaqësues nga organizatat/rrjetet rinore, Korçë
20. Përfaqësues të çdo komuniteti etnik në Korçë.

2. Në kushte pamundësie pjesëmarrjeje, të gjitha institucionet pjesëmarrëse në KVSP mund t'i delegojnë përfaqësimin një drejtuesi tjetër brenda institucionit.

3. Të miratojë Rregulloren e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Të caktojë një Koordinator të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, të emëruar nga Kryetari i Bashkisë. Koordinatori do të jetë përgjegjës për punën e KVSP, mbajtjen e kontakteve mes përfaqësuesve, koordinimin e axhendës së mbledhjeve të KVSP-së si dhe mbarëvajtjen e përgjithshme të proceseve teknike të organizimit të punës së KVSP-së.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Erjon Nexhipi